



Pranuar / Dorezuar Punë / Proje / Dokument / Delivery	11.08.2023	Viti / Godi / Year	3
Organizator / Organizator / Applicant	Mr. Prof. / Dr. Prof. / Prof. No.	Shtesa / Prilog. / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKRIMTACH	5627/2023		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.885/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.58/2021 të datës 13.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.793/2022 të datës 14.06.2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.326/2020 të datës 27.10.2020 të parashtruar nga ankuesi _____ ne adresë rruga "Lot Voku", Objekti C03, Krapë 2 në Prishtinë, kundër organit të punësimit-Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.326/2020 e datës 27.10.2020 e parashtruar nga ankuesi _____, ashtu që aprovohet pretendimi ankimor lidhur me shtesën mbi pagën bazë për kushte specifike, *refuzohet* pretendimi ankimor lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive të shtesës për kushte specifike të punës.
- II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi që rregullon çështjen për kushte specifike.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

, Inspektor i Sigurisë së Produkteve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, më datë 23.10.2020 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shtesës mbi pagën bazë për shkak të kushteve specifike të punës, dhe punës jashtë orarit. Ankesa e ankuesit është pranuar më datë 27.10.2020 dhe është protokolluar me numër Nr. Prot: 2280/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.11.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë te Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Kjo e fundit më datë 10.11.2020 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.12.2020 ka nxjerr Vendim me numër A.nr. 326/2020, me të cilin vendim e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit. Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër A.nr.326/2020 të datës 03.12.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka iniciuar konflikt administrativ në gjykatën kompetente përkatësisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 13.09.2022 nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.51/2021 me të cilin e aprovon si të bazuar kërkesë padinë e paditësit, duke anuluar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër këtij aktgjykimi, më datë 24.10.2022 parashtron ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë. Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative me datë 14.06.2023 nxjerr Aktgjykim me numër AA.nr.793/2022 me të cilin e refuzon si të pa bazuar ankesën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa e vërteton Aktgjykimin me numër A.nr.58/2021 të gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:2280/2020 të datës 27.10.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratën e Marrëdhënies së punës e datës 08.07.2008 e ankuesit; Vendimin me numër 02 Ref.114/7-2008 i datës 08.07.2008 për transferimin e ankuesit; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 10.02.2015 për ankuesin; Akt Emërimit e datës 30.01.2012 i ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Inspektor i Mbikëqyrjes së Tregut për shërbime hoteliere dhe turistike" i datës 31.01.2012; Kërkesën e datës 04.09.2020 nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Tregut për Ministrinë e MTI-së; Kërkesën e datës 03.09.2020 nga Inspektoret e Tregut për Ministrinë e MTI-së; E-mailin e datës 03.09.2020, 03.06.2020 nga Lulzim Sylaj; E-mailin e datës 28.05.2020, 26.05.2020 dhe 18.05.2020 nga A.D; E-mailin e

datës 14.05.2020 dhe 07.05.2020 nga [blank]; E-mailin e datës 06.05.2020 nga A.D; E-mailin e datës 27.08.2020; E-mailin e datës 14.05.2020 nga L.S; Kërkesën e datës 05.05.2020 nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Tregut për U.D Sekretarin e Përgjithshëm të MEPTINIS; Organizmi dhe Funkzioni i Inspektorateve në Kosovë; Ligji Nr. 04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut; E-mailin e datës 04.11.2020 nga M.B; E-mailin e datës 04.11.2020 nga V.R-V; Kërkesa sipas Qarkores Buxhetore 2021.02 nga Zyrtarja Kryesore Financiare e MTI-së për Ministren e Ministrisë së Financave; Qarkorja Buxhetore 2021/02 për kërkesa shtesë; Shkresën me numër protokolli 3294/2020 të datës 24.12.2020; Aktgjykimin A.nr.58/2021 të datës 13.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit AA.nr.793/2022 të datës 14.06.2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën e datës 24.10.2022 e parashtruar në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka rishqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët si dhe duke marr parasysh pikëpamjet juridike sipas Aktgjykimit A.nr.58/2021 të datës 13.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit AA.nr.793/2022 të datës 14.06.2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës "*Inspektor i Sigurisë së Produkteve*" sipas Akt Emërimit të datës 10.02.2015, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Ankuesi më datë 03.09.2020 ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për pagesën e shtesë mbi pagën bazë nga 100 deri 200 euro, ndërsa në mungesë të përgjigjes nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ankuesi me datë 27.10.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se i takon e drejta në realizimin e shtesës në pagë për shkak të kushteve specifike në punë dhe punës jashtë orarit, siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, i publikuar në Gazetë Zyrtare me datë 10.05.2013.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër A.nr.326/2020 të datës 10.12.2020 ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për shtesën në pagë për shkak të kushteve specifike në punë, duke vlerësuar se realizimi i shtesës për kushte specifike të punës për ankuesin mund të bëhet vetëm pas aprovimit nga institucionet përgjegjëse respektivisht Ministria përgjegjëse për Administratë Publike, siç parashihej me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i aplikueshëm në kohën e shqyrtimit të ankesës A.nr. 326/2020 të datës 27.10.2020 përkatësisht nenin 16 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "*...institucioni kërkon miratimin e një shtese për kushte të punës për këta nëpunës civil, sipas aktit nënligjor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni*", si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht

nenit 7 paragrafi 3 ku përcaktohet se: " ...për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta, institucioni duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike kërkesën që përmban: 3.1 arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte specifike të punës për pozitën (at) përkatëse; 3.2 listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civil për çdo pozitë; 3.3 detajet, sipas të cilave, secila pozitë përkatëse pritet të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut; 3.4 koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushte specifike të punës.

Kolegji i Këshillit, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar, se organi i punësimit në zbatim të Vendimit të Këshillit A.nr.326/2020 të datës 03.12.2020, përmes shkresës me numër protokolli 3294/2020 të datës 24.12.2020 ka njoftuar Këshillin që me datë 18.12.2020 kanë parashtruar kërkesë të Ministria e Punëve të Brendshme si ministri përgjegjëse për Administratë Publike për miratimin e shtesës për kushtet e tregut si dhe caktimin e shumës së shtesës, mirëpo që nga provat e lëndës nuk vërtetohet së kjo kërkesë është miratuar.

Andaj, duke qenë se në riprocedurë kemi rrethana të reja ligjore, përkatësisht kemi ndryshime ligjore përkitazi me sistemin e pagave dhe shtesave të nëpunësve civil, Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin ankimor për shtesa të veçanta mori parasysh dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i aplikueshëm nga data 05.02.2023, i cili me dispozitat e nenit 45 ka shfuqizuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe çdo dispozitë të ligjit apo të aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.

Bazuar në nenin 26 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik është përcaktuar se: Shtesa për kushte specifike të punës përfitohet nga zyrtaret/ët publik dhe të punësuarat/it e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin. 2. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 1% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar. 3. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 4. Me rastin e krijimit të funksioneve, pozitave, apo emërtesat e reja sipas nenit 42 të këtij ligji, institucioni në të cilin krijohet pozita, kur e vlerëson se kësaj pozite duhet ti takoj shtesa për kushte specifike të punës, kërkon nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse e financave pëlqimin për përfitim të kësaj shtese. 5. Pozitat përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushte specifike të punës, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohen me akt nënligjor nga Qeveria pas propozimit nga ministria përgjegjëse për finance. Ndërsa Rregullorja (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, me dispozitat e nenit 7 ka paraparë se: 1. Secili institucion që vlerëson se ka zyrtarë publikë dhe të punësuar të tjerë që plotësojnë kriteret për të përfituar këtë shtesë dorëzon kërkesën për miratim të shtesës për pozitat përkatëse tek Komisioni sipas paragrafit 2 të këtij neni, me të dhënat si në vijim: 1.1. pozitën dhe numrin e të punësuarve në këtë pozitë; 1.2. përshkrimin e punës të të punësuarit; 1.3. arsyetimin e detajuar për përfitimin e shtesës; 1.4. klasën dhe koeficientin. 2. Kërkesa sipas paragrafit 1, dorëzohet tek Komisioni i cili themelohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me mandat tre (3) vjeçar, në këtë përbërje: 2.1. përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit; 2.2. përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për

financa; 2.3. përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike.... 5. Komisioni është përgjegjës të përpiloj raport përfundimtar në bazë të kërkesave të institucioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni, i cili duhet të përmbaj: 4.1. lista me pozitat për të cilat kërkohet shtesa e kushteve specifike të punës, të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin përkatës për pagat dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje; 4.2. vlerën indikative të rekomanduar për secilën kategori potencialisht përfituese të shtesës për kushte specifike të punës, duke respektuar kufizimet buxhetore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi; 4.3. shkaqet për mos përfshirjen e kërkesave të tjera të pranuar në përfitimin e shtesës; dhe 4.4. informatat tjera që konsiderohen relevante nga Komisioni. 5. Me nxjerrjen e raportit përfundimtar, Komisioni dërgon të njëjtin për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës. 6. Qeveria, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria përgjegjëse për Financa, miraton të gjeturat e Komisionit përmes vendimit qeveritar. 7. Komisioni, në çdo kohë dhe në bazë të kërkesës së institucioneve, mund të rishikojë listën e aprovuar në Qeveri dhe të propozojë ndryshimin e saj.

Andaj, Kolegji pas analizimit të bazës ligjore dhe konstatimit si me lartë, vlerëson se Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura procedurale për trajtimin e çështjes që është objekt i kësaj ankese, rrjedhimisht, në pajtim me dispozitat e nenit 26 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik si dhe nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, të parashtrorj kërkesë për miratimin e shtesave për kushte specifike te komisioni kompetent.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës për kushte specifike të punës, në mënyrë retroaktive duke filluar nga data 25.05.2013, Kolegji ka konstatuar se ky ligj është publikuar në Gazetë zyrtare me datë 10.05.2013, ndërsa ankuesi nga data e emërimit në pozitën "Inspektor i Sigurisë së Produkteve" me datë 10.02.2015 deri me datë 27.10.2020 (data e parashtrimin të ankesës) nuk kishte ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të realizimit të kësaj drejte, andaj mbi këtë bazë rrjedhë së pretendimi ankimor për kompensimin e shtesës në mënyrë retroaktive është i pabazuar për faktin se ankesa është e parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.885/2022, datë 11/08/2023

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së